



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 63/12
Prishtinë, më 08.05.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmanaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante), Kushtrim Aliu (praktikant), Dafina Krasniqi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Avdiu zv. Minister i Financave dhe Qerkin Berisha Drejtor i Departamentit Ligjor nga MF, Ahmet Tmava, Selvete Grejgevc, Haradin Gërvalla dhe Ibush Januzi nga KPMM, Bajram Ajeti dhe Miran Zeneli nga KPMSHCK, Musli Krasniqi nga Kuvendi i Kosovës, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj, Juergen Schatz nga GIZ, Florije Mehmeti monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më 02.05.2012;**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;**
4. **Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës në Kosovë;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-92 për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;**
6. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011;**
7. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2011;**
8. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisioni për Ndihmë Juridike për vitin 2011;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më 02.05.2012

Kryetarja, konstatoi se procesverbali miratohet unanimisht.

3. Shqyrtimi në parim Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

Kryetarja, theksoi se me këtë projektligj rregullohen disa çështje që kanë të bëjnë me transferin e kompetencave nga institucionet ndërkombëtare në institucionet vendore dhe me themelimin e fondit rezervë për asistencë emergjente të likuiditetit financiar si pjesë e marrëveshjes me FMN. Në këtë projektligj nuk ka ndonjë kosto shtesë dhe nuk ka çështje që i cenojnë parimet themelore të legjislacionit të BE.

Ramadan Avdiu, bazuar në dispozitat e këtij projektligji thesari do të themelojë fondin special të rezervave për asistencë emergjente të likuiditetit të sistemit financiar. Ky fond do të mbahet në llogari të Bankës Qendrore dhe do të qeveriset, administrohet dhe shfrytëzohet në pajtim me rregullat ligjore të përcaktuara me Ligjin e BQK-së. Ky projektligj nuk ka kosto shtesë për Buxhetin e Kosovës dhe me miratimin e tij Qeveria e Kosovës do të jetë një hap më afër përmbushjes së obligimeve të marra para FMN dhe përfitimet nga programet e tij. Me kërkesë të FMN është parë e nevojshme që në ligj të futet një dispozitë e cila i jep fuqi ligjit për Menaxhimin e Financave Publike në krahasim me ligjet tjera, kur është në pyetje menaxhimi i parasë publike.

Muhamet Mustafa, theksoi se rezerva e detyrueshme si pjesë e bilancit bankar të Kosovës është tepër e madhe dhe ngarkon shumë koston e financimit të buxhetit. Kuptoj që FMN kanë një drojë për shkak të disiplinës tonë financiare dhe menaxhimit të financave publike dhe për të siguruar stabilitetin financiar. Kjo është një kosto shumë e madhe sepse përderisa mbajmë mjete të mobilizuara në bilancin bankar, ne marrim kredi. Mendoj se 40 % e kësaj rezerve mund të shfrytëzohet.

Qerkin Berisha, Qeveria nuk mund ta shfrytëzojë këtë rezervë që është me likuiditet pa pëlqimin e Bankës Qendrore. Qeveria ka filluar ta nënshkruaj një memorandum të mirëkuptimit me Bankën Qendrore për rregullat dhe procedurat se si ka mundësi të shfrytëzohet ky fond.

Muhamet Mustafa, propozoj një rekomandim Ministrisë së Financave në diskutimet me FMN të shikojnë arsyeshmërinë e detyrimit që kemi një rezervë aq të madhe bankare.

Pas diskutimeve, Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmanaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), Asnjë Kundër dhe dy Abstenime (Sali Asllanaj dhe Hykmete Bajrami), nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës në Kosovë

Kryetarja, theksoi se analizat që ka bërë Ministria e Financave për caktimin e normës së akcizës në këto mallra duket se është e arsyeshme pasi që importimi i tyre ndikon drejtpërdrejtë në ambient dhe në shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Aplikimi i akcizës në këto produkte do të mund të ndikonte në kursim dhe përdorim eficient të energjisë si dhe mbrojtjen e ambientit nga ndotja. Aplikimi i akcizës nga mallrat e përmendura janë në përputhje me praktikat e vendeve të regjionit dhe të Bashkësisë Evropiane dhe me rekomandime të asistencës teknike të Fondit Monetar mbi politikat tatimore në Kosovë.

Hykmete Bajrami, me këtë propozim sikur po i ndëshkojmë qytetarët e vendit tonë, se nuk besoj që ka në Kosovë ndonjë qytetar që blen goma të përdorura nëse ka mundësi t'i blej gomat e reja, mirëpo këtë ia imponojnë kushtet ekonomike. Sa i përket akcizës në poqa elektrik të thjeshtë arsyetimi jepet se kjo ka për të ndikuar në ruajtjen e energjisë, mirëpo kemi ashtu disi një veprim i qeverisë kundërshton tjetrin. Patëm para pak ditëve bordin e KEK-ut dhe mori një vendim për rehabilitimin e bllokut A2 të termocentralit A i cili është i vjetër 48 vjet. Një poq elektrik që kushton 50 cent për momentin në treg e ngarkojmë me akcizë 30 cent, ndërsa në të njëjtën kohë po mundohemi të rehabilitojmë këtë bllokun A2 në kuadër të termocentralit A, nuk e shoh të arsyeshme. Po e shoh Ministrinë e Financave duke i dhënë këto akciza vetëm në funksion të grumbullimit të atyre 38 milionëve të zotuar para FMN që do t'i mbledhë me taksa shtesë deri në fund të vitit 2012.

Muhamet Mustafa, sa i përket propozimit për akcizën në gomat e përdorura, kjo mund ta ngrisin koston e biznesit pra rrisin koston e jetesës së qytetarëve.

Sali Asllanaj, me këtë propozim po preken kategoritë që janë sociale. Me këto 5 euro shtesë që bëhet për një gomë nuk ndryshon këtë proporcion, prapë do të blihen gomat e vjetra, vetëm që buxheti i Kosovës do t'i ketë 2.6 milion euro më shumë. Do të duhet të vendosur akciza për gjëra të luksit, alkoolin, duhanin çka shpenzojnë të pasurit, e të mos prekim gjëra që e cenojnë standardin jetësor të një pjese të madhe të popullsisë. Ka hapësirë ta ngrisni akcizën e alkoolit në maksimum si në përfundim gjithashtu dhe duhanit. Për këto argumente nuk e përkrahu këtë kërkesë sepse po e cenon një kategori që nuk ka kushte të mjaftueshme për jetë.

Xhevdet Neziraj, theksoi se kërkesa për akciza te qeset e plastikës kemi një shënim që 1.8 milion kg brenda vitit, kjo lenë të dyshohet që kemi të bëjmë edhe me pjesën që përdoret në bujqësi. Nëse përdoret në bujqësi dhe preket edhe ajo lëmi atëherë do të jetë një problematikë dhe shumë gjëra tjera që mund të ndikojnë në koston e jetës së njerëzve por mund edhe ta destimuloj bujqësinë. Dua ta di nëse është direkt vetëm në qese apo prek edhe pjesë tjera te sektorit të bujqësisë?

Ramadan Avdiu, bëhet fjalë vetëm për qeset e plastikës jo dhe për materiale plastike të cilat mund të shfrytëzohen si lëndë e parë, në industri apo bujqësi. Sa i përket poqëve është çështje tjetër politika e KEK-ut dhe e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për zhvillimin dhe rehabilitimin e bllokut A2 prej poqëve. Dihet se 3 fish shpenzon më shumë një poq inkandeshent se sa një flouroshent. Qasja e Qeverisë është që gradualisht të shkohet nga zhvendosja dhe eliminimi i përdorimit të poqëve inkandeshent, shpenzojnë shumë dhe afati i qëndrueshmërisë është shumë i shkurtër. Sa u përket gomave është e vërtetë se mund të preket një kategori, por esenca e vendosjes së akcizës në goma është për të vendosur një siguri në komunikacion. Ne konsiderojmë përveç dobisë që mund të kenë qytetarët, vendosja e akcizës në këto tri produkte do të bëjë që të paktën 10 milionë euro t'i grumbullojë të ketë të hyra buxhetore.

Sali Asllanaj, zakonisht masat e ndërmarra në një procedurë siç është akciza do duhej të pasohen me një masë e cila dërgon në drejtim të mbrojtjes së ambientit. Pastaj nëse gomat po shkaktajnë aksidente më shumë në trafik, rritja e çmimit për 5 euro për një gomë, shumë pak ka për ta ndryshuar ndërrimin prej gomave të vjetra në goma të reja sepse është diferenca shumë e madhe në çmim.

Kryetarja, në bazë të ligjit, Komisioni duhet të shpreh pëlqimin për qeverinë lidhur me këto propozime. Unë mendoj që është e arsyeshme vendosja e një akcize duke ditur gjendjen në teren në lidhje me gomat e vjetra të importuara dhe me qeset e plastikës të cilat janë bërë të padurueshme tek ne, me ndikime negative për ambientit. Po ashtu edhe qëllimi për ndërrimin e poqave elektrik me qëllim të përshtatjes me standardet evropiane është i mirëseardhur.

Pas diskutimeve, Komisioni me shtatë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmanaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi dhe Muhamet Mustafa), dy Abstenime (Sali Asllanaj dhe Hykmete Bajrami), dhe një Abstenim (Xhevdet Neziraj), nxori këtë

REKOMANDIM

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu propozimin e Qeverisë së Kosovës për shtimin e listës së mallrave dhe caktimin e normave të tatimit të akcizës në gomat e përdorura, poqat elektrik (të thjeshtë – inkandeshent) dhe në qese të plastikës, në Aneksin A të Ligjit nr.03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.
2. Qeveria në vendimin e saj të vendos shifrat për mallrat që do plotësojnë Aneksin A të Ligjit nr.03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-92 për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat të Pagjetur dhe Peticione**

Kryetarja, projektligji përmban implikime buxhetore, të cilat janë cekur edhe deklaratën financiare të Ministrisë së Financave. Komisioni Funksional, i ka bërë disa amendamente të cilat prodhojnë kosto buxhetore shtesë. Është fjala tek amendamenti 10 që ka të bëjë me nenin 7.2. Paga minimale është e përcaktuar me vendim të Qeverisë dhe Këshillit ekonomik fiskal, nëse mbetet me pagën mesatare mund të bëhet ligji i pazbatueshëm dhe ngarkohet me kosto buxhetore shtesë sepse nuk ka ndonjë dokument që e verifikon sa është paga mesatare. Komisioni Funksional e ka hequr edhe një nen që është neni 21.

Albana Fetoshi, mendoj që kostoja financiare nuk është e lartë dhe është e përballueshme për buxhetin shtetëror dhe mendoj që të mbetet neni 7.2 që përcakton përfitimet në 60 % të pagës mesatare. Paga mesatare mund të përcaktohet shumë lehtë nuk është arsyetim që nuk e kemi në ligj dhe nuk kemi se si ta përcaktojmë.

Ramadan Avdiu, lidhur me këtë projektligj ne kemi insistuar të ndryshohet dhe të hiqet ajo pjesërisht të verbër sepse gama e përfituesve do të jetë shumë e madhe dhe do të jetë e papërbalueshme për buxhetin. Por edhe mënyra se si është propozuar nga komisioni funksional paraqet implikime shtesë buxhetore dhe të merret paga minimale sepse pagë mesatare nuk ka në Kosovë. Ne do të llogarisim edhe marrëveshjen që kemi me FMN kjo kategori që përfiton nga buxheti i shetit do duhet të gëzojnë edhe benificione tjera kanë impakt jo të drejtë buxhetor.

Naser Osmani, çështja e kategorisë që janë pjesërisht të verbër jam për variantin që tha zv. Ministri por jam edhe për atë që tha Albana sepse është një kategori më specifike për të cilën ne si shoqëri është dashur të kemi kujdes, këta janë të varur prej kësaj shume të mjeteve ne kishim me iu lejuar. Nëse iu lejojmë prej pagës minimale ajo mund të jetë shumë e ultë, unë qëndrojë mbas asaj se kësaj kategorie pagën duhet t'i u lejuar sipas ligjit mos me ia lënë në disponim Ministrin të Financave apo Kryeministrin.

Qerkin Berisha, njoftoi se jemi pajtuar me FMN, njëra prej pikave është që ne nuk guxojmë me iu referuar as pagës minimale as pagës mesatare. Po ashtu një kërkesë është që të gjitha ligjet që krijojnë përfitime duhet m'u përfshi një paragraf që lejon mundësinë e shkurtimeve buxhetore në rast se vihet në rrezik likuiditeti i vendit.

Sali Asllani, nuk është në dobinë tonë kjo që kjo që të përcaktojmë shkallën e invaliditetit dhe realisht nuk e kontestojmë që ata kanë nevojë për ndihmë po duhet një analizë e tillë që sa janë kategori e tillë dhe sa mund me përballu buxheti i Kosovës?

Albana Fetoshi, duhet me pas parasysh që është një kategori që nuk ka kushte ndoshta minimale për jetë. Është shumë absurde me mendu që 60 % e pagës minimale me iu ofruar këtyre kur dihet që paga minimale në Kosovë është shumë e vogël e përkundër asaj page shumë të vogël në po iu ofrojmë vetëm 60 % të asaj page minimale. Në projektligj as nuk përcaktohet bile as 60 % e asaj page mirëpo i lihet njëfarë vendimi me marrë Qeveria për këtë punë. Për këto kategori duhet me mendu shumë, mos me u kufizuar në shifra kaq të vogla.

Xhevdet Neziraj, vlerësoi se kemi të bëjmë me një kategori shumë specifike që kërkon përkrahje institucionale dhe si rezultat përkrah mendimin e nënkryetarit të komisionit për ndryshimet në nenin përkatës.

Ramadan Avdiu, nga shoqata e të verbërve ka ardhur një numër mbi 1400 persona por nuk ka numër të saktë dhe ne e dimë që po sa të aprovet ligji do të rritet kjo kategori sepse do të paraqitën edhe ata persona që nuk janë anëtar të shoqatës së të verbërve dhe realisht janë të verbër. Prandaj në kemi llogaritu një shumë mbi 1 milionë e 300 mijë euro që të ndahet për këtë kategori dhe nëse rritet numri i këtyre personave nuk do të mundemi të ndajmë buxhet shtesë.

Kryetarja, me këtë ligj personat e verbër kanë lehtësinë në punësim, lirohen nga taksat dhe tatimet, strehim, përkujdes shëndetësor, edukim dhe arsim, qasje në informacion, rehabilitim, udhëtim, energji elektrike, telefona, infrastrukturë. Nuk do të doja të bënim politikë në këtë kategori të personave të verbër por të mendojmë seriozisht që ligji të bëhet i aplikueshëm. Nëse ne fusim një fjali që nuk duhet atëherë ka pengesa të llojllojshme. Ne i rekomandojmë komisionit funksional të bëj ndryshime. Amendamenti 10 neni 7.2 është që personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj marrin nga buxheti shtetëror pensionin në një shkallë të caktuar pensionin bazuar në pagën minimale në Kosovë dhe përcaktohet me aktet nënligjore të nxjerra nga Qeveria. Propozimi i dytë është tek amendamenti 23 që thotë të fshihet neni 21, ne rekomandojmë që të mos fshihet neni 21.

Hykmete Bajrami, nëse kostoja e ligjit është 1 milion e 300 mijë që i bie diku rreth 70 euro nëse kemi mbi 1.400 persona të verbër, e që do të thotë nuk është as 50 % e pagës minimale që është 170 euro në muaj.

Latif Gashi, jam dakord me të gjitha diskutimet e parafolësve, është në pyetje një kategori që ka nevojë shumë, por duke i pasur parasysh mundësitë e buxhetit të Kosovës, të lejmë vullnetin dhe dëshirat dhe unë jam dakord që amendamenti 23 të fshihet dhe neni 7.2 të riformulohet, me qëllim që ligji të jetë funksional.

Sali Asllanaj, vërtetë mund me qenë shumë i ultë ai kompensim për të verbër sepse 1400 janë paraqit, ka mundësi që do të paraqitën shumë më tepër do të arrij shifra 2,000 e atëherë del shuma shumë e vogël 50 euro.

Latif Gashi, realisht mendoj që u bë ajo që ka qenë e mundshme për momentin, nuk kisha dashur që me pas debate politike, është e rregulluar kur thuhet një këshill ekonomiko-social që do të merret edhe mendimi i tyre që do t'i propozojë qeverisë.

Naser Osmani, propozoj që riformulimi të bëhet: Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj marrin nga buxheti shtetëror pensionet në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë por jo më pak se 100 euro dhe të përcaktuar me akte nënligjore të nxjerra nga Qeveria.

Kryetarja, miratohet propozimi i zëvendëskryetarit për ndryshimin e nenit 7.2 me një votë Kundër (Albana Fetoshi), asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Si dhe miratohet propozimi për fshirjen e amendamentit 23 që i referohet nenit 21, me dy vota Kundër (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi), një Abstenim (Muhamet Mustafa) dhe të gjithë tjerët Për.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni nxori këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr.04/L-92 për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për Projektligjin nr. 04/L-92 për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, më përjashtim të amendamentit 10 që i referohet ndryshimit të nenit 7.2 dhe amendamentit 23.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon të bëhen ndryshimet, si në vijim:

A). Amendamenti 10, nenit 7.2., të riformulohet si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 7

Paragrafi 2, riformulohet si vijon:

7.2 Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror pensionin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se 100 (njëqind) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

B). Amendamenti 23 i komisioni funksional, **të hiqet.**

6. Shqyrtimi i Raporti Financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011

Kryetarja, nëse analizojmë raportin financiar të KPMM-së shohim se është i detalizuar, janë përfshi të dhëna të cilat na japin një pasqyrë se sa janë planifikuar sa janë shpenzuar dhe njëkohësisht është i detalizuar dhe mund të shohim se sa janë shpenzuar për secilën kategori të shpenzimeve.

Ahmet Tmava, prezantoi buxhetin dhe shpenzimet e KPMM-së për vitin 2011. Njoftoi se janë shfaqur disa probleme financiare sidomos rreth konfiskimeve, ku procedurat e konfiskimeve kanë kushtuar jashtë mase dhe këtu infrastruktura ligjore nuk ka qenë e qartë kush bënë transportimin e mjeteve të konfiskuara dhe duke qenë se kemi të bëjmë me një veprimtari shumë të ndjeshme edhe çmimi ka qenë i lartë dhe në Agjensionin për menaxhim të pasurisë së konfiskuar dhe Ministrinë e Ambientit kemi kërkuar ndihmë.

Latif Gashi, keni paraqitur që ka shumë kompani kanë obligime të papaguara siç janë obligimet e pakryera, taksat administrative, renta minerale dhe gjobat administrative. Kush është përgjegjës për këto që nuk janë paguar edhe a keni ndërmarr ju ndonjë veprim konkret ? Edhe keni bërë ndonjë kërkesë për mjete shtesë, për çka e keni kërkuar ?

Ahmet Tmava, ka shumë obligime të papaguara, konform ligjit për Miniera dhe Minerale për herë të parë ju do të ballafaqoheni më aprovime të rentës minerare duhet ta propozojë Ministria për Financa. Mënyra e kryerjes së obligimeve financiare është bërë konform ligjit dhe kemi inkasim në rritje nga viti në vit. Kompanitë të cilat iu kanë nënshtruar proceseve të falimentimit ose i është pezulluar licenca janë bërë kallëzime penale në mënyrë që obligimet. Për reflektimet ambientale nuk është përgjegjës KPMM sepse japim licenca me pëlqim të ministrisë së ambientit. Licenca nuk mund të merret dhe nuk është marrur asnjë deri sot pa u marrë pëlqimi nga kuvendi komunal nëse bie apo jo ndesh me planet rregullative komunale ose rurale në aspektin e zhvillimeve rurale të komunave. Jepet edhe pëlqimi prej ministrisë së ambientit.

Hykmete Bajrami, kur folët për licenca a patët fjalën për licencën për hulumtim apo licencën e vërtetë? Ju lëshoni licenca për hulumtim, njerëzit shembin kodra me dhjetëra hektar, mandej edhe pse nuk ia jepni licencën për eksploatim ai nuk brengoset, se ai po eksploaton atë vend. Për sa kohë ju i lejoni njerëzit të eksploatojnë? Çfarë hapësire mundet ta shkatërroj ai në emër të licencës në hulumtim?

Ahmet Tmava, asnjë gram i vetëm i gurit nuk është shfrytëzuar në emër të licencave të hulumtimit. Është shfrytëzuar në bazë të kontratës. Dua të them që në bazë të raporteve të inspektoratit të KPMM-së, asnjë kompani nuk ka bërë eksploatim me licencë eksploatimi, ato që kanë bërë kanë hyrë në procedurë të gjobitjes.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raportit të KPMM-së për vitin 2011.

7. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2011

Kryetarja, nga raporti shihet se buxheti është shpenzuar sipas llogarive që ka disa defekte në kalkulime. Shpenzimet diku 99.97% të buxhetit. Megjithatë nuk kemi të dhëna të detalizuara për nënkategoritë ekonomike si është shfrytëzuar buxheti.

Bajram Ajeti, buxheti ka garantuar pavarësinë e këshillit me punën e vet, megjithatë më këtë buxhet mund ta vëreni se çfarë dallime ka midis buxheteve të organeve të pavarura, kushtetuese dhe të tjerave. Kemi pasur vështërsi me këtë buxhet të kryejmë funksionet tona posaçërisht monitorimin e institucioneve për të cilat jemi të obliguar të bëjmë monitorim që dmth. vizita të drejtpërdrejta që mund të ndodhë që iu bie në sy

se ka shpenzime të karburanteve në suaza normale dhe të mirëmbajtjes së automjeteve. Kopja fizike e pasqyrës me të gjitha tabelat e të gjitha shpenzimeve është dorëzuar sot.

Miran Zeneli, buxheti në total është shpenzuar 99.97%. Këshilli ka nxjerrur edhe planin e shfrytëzimit të këtij buxheti i cili është shfrytëzuar gjatë vitit 2011 brenda kufijve të planifikuar, nuk ka tejkalim të shpenzimeve në asnjë kategori ekonomike. Vështërsitë tani po vijnë si rrjedhojë e ngritjes së kostos së karburanteve.

Kryetarja, njoftoi se sot ka ardhur materiali plotësues që janë prezantuar shpenzimet e detalizuara. Mund të pranojmë si raport plotësues dhe të ia bashkagesim raportit vjetor dhe të procedojmë për Kuvend.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raportit të KPSHCK-së për vitin 2011.

8. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2011

Kryetarja, theksoi se në raportin në dispozicion janë paraqitur të dhënat në mënyrë të përmbledhur. Megjithatë shënimet janë të përmbledhura nuk janë të paraqitura si janë planifikuar dhe shpenzuar sipas kategorive ekonomike. Buxheti i total është 287 mijë e 845 euro kanë pasur në fillim të planifikuar, kurse sipas shënimeve të paraqitura këtu janë shpenzuar 99% mirëpo këto tabelat e paraqitura këtu pjesa e shkurtuar nuk është përfshirë si duhet në tabelën kryesore. Nuk janë paraqitur shpenzimet e metalizuara.

Drita Rexhepi, përkundër buxhetit të vogël kemi treguar rezultate për shkak se shumica prej stafi që i kryen nga 2 ose 3 detyra, sepse varësisht nga numri i stafit procedurat që kërkohen nga Qeveria duhet të kenë pozita të caktuara për zyrtarë certifikues, zyrtarë zotues, financiar, për pranimin e mallit, për auditim të brendshëm, për marrëdhënie me publikun. Drejtori ekzekutiv nuk ka asistentin e vet. Pagat e stafit ekzistues janë minimale. 12 zyrtarët që ofrojnë ndihmë juridike paga e tyre është me koeficient 7. Brengë tjetër janë mjetet e vogla për angazhimin e avokatëve. Pagat janë realizuar si janë paraparë. Një gjë që e ka cunguar buxhetin tonë ka qenë vendimi i Kryeministrit që nga organizata jone buxhetore të merren 6 % të mjetëve ku buxheti është zvogëluar në vlerë prej 8 mijë e 542. është bartur edhe një shumë në vlerë prej 200 euro por në tërësi buxheti është realizuar si është planifikuar. Sa i përket vërejtjes tuaj raportin shtesë të kërkuar do ta sjellim.

Latif Gashi, theksoi se nga raporti i marrë nuk janë paraqitur nënkategoritë ekonomike. Raporti është i mangët nuk ka të dhëna e kërkuara.

Daut Morina, theksoi se ne nuk kemi dashur ta ngarkojmë raportin. Ne mund t'ia bashkagesim detajet e kërkuara.

Kryetarja, në raport nuk janë të përfshira shpenzimet e detalizuara. Edhe vitin e kaluar kemi kërkuar të na ofrohet një raport shtesë më i detalizuar i planifikimit të buxhetit dhe realizimit të shpenzimeve. Mendojë që për shkak të praktikës jo të mirë të raportimit të këtij Komisioni që është përsëritur edhe këtë vit, do të duhej të kërkojmë raport plotësues financiar dhe të shqyrtojmë në një mbledhje tjetër të Komisionit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni nxori këtë

PERFUNDIM

Shtyhet shqyrtimi i raportit financiar i KNJ-së për vitin 2011 për një mbledhje tjetër të Komisionit. Kërkohej nga Komisionit për Ndihmë Juridike të sjell një raport të detalizuar financiar.

9. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi anëtarët se eksperti i GIZ-së, z. Juergen Schatz, do të përfundojë punën me GIZ, dhe për arsye të caktuara, do të shkojë për të jetuar në SHBA. Në emër të Komisionit falënderoi për gjithë kontributin që ka dhënë në mbështetjen e Komisionit.

Juergen Schatz, falënderoi anëtarët për bashkëpunimin e ndërsjelltë që kanë pasur. Theksoi se ka përfituar nga përvojat e njëri-tjetrit dhe shteteve përkatëse. Do të përfundojë misionin në GIZ në këtë formë, por jo përgjithmonë pasi që shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar në forma tjera me Komisionin për GIZ.

Mbledhja përfundoi: 11:55

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj